

- 2 Intergimi dhe aftësimi profesional**  
Të mos përjashtohet askush, pavarësisht statusit
- 3 50 vite nga iniciativa e Schwarzenbach-ut**  
Ksenofobia atërherë dhe tani
- 4 Pandemia dhe udhëtimi për në vendëllindje**  
Rregullat e udhëtimit nëpër vendet përkatëse

Nr. 4 | qershor 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Soloidarizim pa përjashtim

## Nevojitet fond tejkaluës për më të prekurit



Të punësuarit me kushte të këqija dhe të pasigurta nuk duhet të anashkalohej nga masat mbështetëse.

**Unia dhe 22 organizata mbështetëse i bëjnë thirrje qeverisë federale dhe kantoneve të sigurojnë fondet e nevojshme për një fond tejkaluës të Covid-19. Ky fond ka për qëllim të sigurojë mbrojtje sociale dhe ekonomike për grupet e njerëzve, të cilët deri tash janë përjashtuar nga masat aktuale mbështetëse.**

**Nga Hilmi Gashi**

Kriza e koronës prek të gjithë shoqërinë – veçanërisht rëndë i prek punonjësit me punë të pasigurta: punëtorët dhe punëtoret në shtëpi private, të cilët/at edhe bëjnë përkujdesjen e fëmijëve, të sëmurëve dhe pleqve, njerëzit pa letra të rregulluara të qëndrimit apo sans-papiers, njerëzit e vetëpunësuar si të «pavarur» ose punëtoret dhe punëtorët e largua nga puna, pa të drejtë përfitim nga Arka e papunësisë. Këta edhe në rrethanat e zakonshme shpesh jetojnë në minimumin ekzistencial: aktualisht nuk kanë të drejtë përfitim nga sigurimi i papunësisë apo ligjit për kompensimin e të ardhurave (EO/APG) dhe rrezikojnë të përballen me nevojën ekzistenciale. Posaçërisht e vështirë është gjendja e punëmarrësve pa pasaportë zvicerane, edhe pse punojnë për shumë vite në Zvicër: Ata nuk kanë të drejtë së paku as për ndihmë sociale, pasi kjo i përkeqëson shanset e tyre për natyralizim, për statusin e tyre të qëndrimit, apo duhet të kenë drojën e dëbimit.

**Organizatat mbështetëse:** AVIVO Schweiz, Christlicher Friedensdienst (cfd), Coordination romande de la grève féministe, Dachorganisation der Frauenhäuser Schweiz und Liechtenstein, Gewerkschaft des Verkehrspersonals (SEV), Gewerkschaft Unia, Gewerkschaft Medien und Kommunikation Syndicom, Humanrights.ch, Institut Neue Schweiz (INES), Médecins du Monde Suisse, Nationale Plattform zu den Sans-Papiers, Netzwerk der Schweizer Selbstständigen, Prointegra.ch, ProKore – www.sexwork.ch, Schweizerische Beobachtungsstelle für Asyl- und Ausländerrecht (SBAA), Schweizerische EMMAUS Vereinigung, Schweizerisches Arbeiterhilfswerk (SAH), Schweizerische Verband des Personals öffentlicher Dienste (VPOD), Solidar Suisse, Solidaritätsnetz Bern, Solidarité sans frontières, Solifonds, Terre des Femmes Schweiz, Terre des Hommes Schweiz, Verein Feministische Wissenschaft (FemWiss)

Me iniciativën e sindikatës Unia, rreth 20 sindikata e organizata të ndryshme, ndër të cilat edhe SEV, prointegra.ch), bënë thirrje Federatës dhe Kantoneve që të veprojnë. Në një letër drejtuar Këshillit Federal kërkojnë krijimin e një fondi për tejkalim të gjendjes Covid-19. Do të duhej mbështetur veçanërisht grupet e personave si në vijim:

**Të punësuarit në amvisnit private:** Shumë fuqi pastruese, kujdestar pleqsh deh fëmijësh në shtëpitë private si dhe të punësuarit nga shtëpia, papritur kanë humbur të ardhurat e tyre. Pasi janë të punësuar nga per-

sonat privat, nuk kanë të drejtë në punë me kone të shkurtuar.

**Sans-papiers (personat pa letra):** Shumica e tyre kanë humbur punën. Pa status të rregulluar të qëndrimit nuk kanë të drejtë në kompensim nga sigurimi i papunësisë apo në ndihmë sociale. Të prekur janë edhe familjet me fëmijë.

**Vetë të punësuarit e vegjël:** Artistët apo punonjëset e seksit kanë humbur të ardhurat e tyre. Nga ndihma e premtuar e koronës nuk marrin asgjë apo ndihmë qesharake. Të «pavarurit» e pavërtetë, të cilët punojnë si korrierët,

shoferët e taksive apo punëtorët e platformave digjitale ekonomike, por edhe shumë krijues kulturor vuajnë nga humbja e madhe e të ardhurave.

**Të shkarkuarit:** Punëmarrësit me kontrata të kufizuara pune, shpesh shkarkohen nga puna në vend se të lajmërohen për punë me kohë të shkurtuar. Një pjesë të tyre ju mungojnë muajt e kontributit, për të përfituar nga paratë e papunësisë.

Komunikata e qeverisë federale ishte e qartë: «Ne nuk do të lëmë asnjëri anash. Ne do të kujdesemi për ju». Ne mbështesim këtë qëndrim pa vërejtje. Pamje të njerëzve, të cilët presin me orë të tëra në këmbë për të marrë ushqim bamirësie, nuk përputhen me këtë premtim. Për shumë të prekur kjo është një poshtërim i rëndë. Federata dhe Kantonet janë të thirrura nga aleanca që të vejnë në dispozicion mjete të mjaftueshme për fondin tejkaluës të Covid-19. Ky fond do të duhej të gjithë atyre që janë lenë anash nga masat jashtëzakonshme tu ofronte një mbrojtje sociale me dinjitet.

### Editorial



Pandemia e Covid-19 ka shkaktuar krizën më të madhe, që ne njohim, në të gjithë botën: Shumë punonjës nuk kanë punë dhe të ardhura dhe ata nuk dinë se si të përballojnë situatën. Kjo edhe në Zvicër, në një shtet të pasur dhe shtet social funksional.

Në vendet tjera, pasojat për punëmarrësit janë edhe më shkatërruese. Pasi pa shtet social shumë njerëz ndodhen në mbështetje dhe vihet në pikëpyetje mbijetesa e zhveshur. Kështu p.sh. punëtorët e tekstilit në Bangladesh, të cilët qepin teshat tona: Kur u mbyllën shitoret tek ne, ata papritur mbetën pa punë, pa të ardhura dhe pa rrjete sociale. Kështu edhe punëtorët që kryejnë punët e porositura në shtëpitë e tyre në Pakistan: Kur firmat e modës anuluan porositë e tyre, humbën pagat e tyre edhe ashtu të këqija dhe rreth 6 milion punonjës/e të tillë/a dhe familjet e tyre mbetën pa kurrfarë të ardhurash. Gjithandej veçanërisht të prekur janë migrantet/ët. Shumë nga ta/o punojnë në sektorë të rëndësishëm sistematikë, mirëpo pasi që kanë kushte e situatë të keqe pune, banimi dhe qëndrimi si dhe pasi që janë më pak të mbështetur se sa vendorët, janë të pambrojtur si përballë virusit ashtu edhe varfërisë.

Këta shembuj tregojnë që problemet në botën e rjetëzuar kanë të bëjnë me të gjithë ne. Një krizë e tillë globale mund të përballohet vetëm përmes forcimit të bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërkombëtar. Dhe megjithatë, SVP/UDC-ja zvicerane dëshiron pikërisht të kundërtën: Me 27 shtator do të votohet për iniciativë e tyre anuluese. Kjo iniciativë synon të anulohet lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të izolohet Zvicrën. Iniciativa kundër migrant(e)ve në vend – edhe pse këtu kryejnë punë me rëndësi jetike për Zvicrën. Kjo ishte dhe vazhdon të jetë rruga e gabuar. Ne kemi nevojë për një botë tjetër: një botë të solidaritetit kundër krizës.

**Marília Mendes**



## News

**Sigurimi privat: KKP e re hynë në fuqi nga 1 qershori**

Kontrata e re e Punës me detyrim të përgjithshëm (KKP) për sektorin e shërbimeve private të sigurimit përbën një seri përmirësimesh në rrafshin e pagave, pushimeve të etërve, administrimin e orarit të punës dhe kontrollit me rastin e ndarjes së mëtejme të mandateve të punës. Kushtet e punës të punësuarve në sigurim do të përmirësohen. Rritja e pagave fillestare varësisht nga kategoria nga 0,5 deri në 1%, shtesë kohore për muajt me përqindje të lartë pune, pushimet e etërve prej 3 ditëve nga 1 ditë sa ishte deri më tani si deh shtojcë për personelin e armatosur. Pos kësaj përmes KKP rregullohet edhe dhënia e mëtejme e mandateve të punës. Unia apelon tek autoritetet zyrtare, që me rastin e konkurseve të marrin parasysh vetëm ndërmarrjet, të cilat respektojnë KKP dhe të cilat kështu vlerësojnë kualitetin dhe kushtet korrekte të punës.

**Weight Watchers duhet ti mbrojtë të drejtat e punëtorëve!**

Weight Watchers Zvicër ka paralajmëruar reduktimin e 110 vendeve të punës në të gjithë Zvicrën. Ndërmarrja multinacionale për reduktim të peshës gjatë procedurës konsultative ka shkelur me të dyja këmbët të drejtat e punëtorëve të prekur dhe refuzon bisedimet. Unia kërkon një intervenim të ri të autoriteteve të Kantoni Vaud (Waadt) dhe fton myshterinjët e klientët që të mbështesin personelin. Sindikata Unia kërkon zgjatjen e afatit të konsultimeve.

**AHV/AVS x13: Nënshkruajeni tani iniciativën**

Që nga fillimi i qershorit 2020 prapë është e mundur të nënshkruhet iniciativa popullore. Pas dy muajsh ndalesë, ne përsëri grumbullojmë nënshkrime për iniciativën sindikalistike «AHV/AVS x13 – Për një jetë më të mirë në pleqëri»: pikërisht në kohe krizash rritja e pensionit të pleqërisë AHV/AVS është më se urgjente, për të ndaluar varfërinë në pleqëri. Ashtu sikur shumë të punësuar kanë një pagë të 13-të, ashtu do të duhej edhe të pensionuarit të marrin pensionin e 13-të të AHV/AVS-it.

Nënshkruaje iniciativën dhe lëri edhe shokët e shoqet dhe fqinjët të nënshkruajnë atë! Fletët e nënshkrimit mund të merren në çdo sekretariat të Unia-s.

**Solidarizim me shkollimin integruar para-profesional (INVOL) Mos të anashkalohej askush, pavarësisht nga leja e qëndrimit**

Frommenwiler Anita & Saulnier Bloch Marie

Tek personat e rrezikuar nga pandemia ne nuk guxojmë të harrojmë njerëzit e rinj, të cilët janë duke ndjekur shkollimin integruar para-profesional (INVOL). Konkretisht fjala është për të miturit dhe të rinjtë e rritur nga sektori i azilit, të cilët duan të arsimohen më tej profesionalisht dhe par këtë duan të kryejnë një zanat. Marrja me sukses e zanatit nuk është e thjeshtë, as në kohë normale dhe as në atë krizash. Kush kërkon azil, sipas rregullit, i ka gjepat e zbrazët dhe një thes plot me trauma. Edhe vetëm një rrjet të dobët familjar e social, i cili do të mund të ndihmonte me rastin e shkollimit, kërkimin e një vendbanimi, apo të një pune. Shkollat profesionale zhvillojnë mësimin online që nga muaji mars 2020, pamarrë parasysh hendekun digjital. Puna, varësisht nga sektori, ose është ndalur tërësisht, ose është intensifikuar. Kjo njerëzve që ndjekin INVOL i qon në një izolim shumë serioz shoqëror.

Shkollat profesionale u hapën me 8 qershor. SEM (Sekretariati Shtetëror për Migracion) me 5 maj ka kërkuar nga kantonet që, nga 11 maj të zbatojnë përsëri provimet gjuhësore për IN-

VOL: I vetmi kusht është një koncept mbrojtës për zbatimin e provimeve fizike. Kjo nuk është korrekte, pasi që nga mesi i marsit është zbatuar shkollimi nga largësia, mundësitë digjitale janë të kufizuara, izolimi shoqëror e njerëzve shumë herë të traumatizuar shkakton pasiguri dhe ka disa muaj që vështirëson arritjen e kompetencave të nevojshme për të dhënë provimin. Këto fakte nuk merren parasysh me rastin e këtij vendimi. Nevojitet urgjentisht më shumë mbrojtje për nevojat e njerëzve të rinj, më pak për zbatimin e provimeve!

Kjo nuk është lojë pingpongu e buxhetit mes kantoneve dhe federatës, por godet realitetin jetësor të disa nga punëmarrësit më të pasigurtë. Nuk duhet të jetë fjala as për ekonomizimin e as për kontrollin e “fuqisë potenciale punëtore”, fjala është për njerëz, të cilët nuk mund të zhvillohen e vlerësohen si robotët apo makina. Realiteti jetësorë i këtyre njerëzve të lëndueshëm tregon, se çfarë shoqërie dhe sindikate duam të jemi ne. Kualiteti jetësor i tyre na përket të gjithë neve.

**Mbrojtja shëndetësore na përket të gjithëve!****Angazhim për koncepte mbrojtëse dhe bashkëndikim**

**Përderisa virusi nuk është mundur, nevojitet koncepte mbrojtëse speciale në vendin e punës. Mbrojtja dhe e drejta e bashkëbisedimit të punëmarrësve duhet të zgjerohen.**

Christine Michel

Në mes të marsit qeveria federale shkaku i përhapjes së koronavirusit ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, nga mesi i qershorit vlen edhe më tej gjendja e posaçme. Në parim janë përsëri të hapura ndërmarrje e sektorë dhe njerëzit gjinden përsëri pranë vendit të punës, ku vlejnë edhe më tej konceptet e posaçme mbrojtëse për punëmarrësit. Masat higjienike (larja e shpeshtë e duarve) dhe rregullat e distancës prej 2 metrash duhet të respektohen. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të ndërmerren masa speciale. Këtu hyjnë ndarjet me panele qelqi, për të mbrojtur arkëtarët në shitore apo bufetierin në lokalet e konsumimit. Ndërsa në kantierë pune, punëtorët e të gjitha profesioneve të ndërtimitarisë të koordinohen në atë mënyrë, që nga moleri deri tek elektrikisti të mos jenë në këmbë përnjëherë. Këtu vlen gjithmonë edhe lejimi i bartjes së maskave, kur pikërisht në profesionet me kontakte klientësh nuk mund të respektohet distanca.

**Mbrojtja shëndetësore është përgjegjësi e shefit**

Kriza ka treguar, se sa e rëndësishme është tema e mbrojtjes në vendin e punës. Pikërisht punëmarrësit në sektorët, që i takojnë kujdesit parësor – pra shitëset, kujdestaret e infermieret, personeli pastrues, shoferët e taksive, punonjësit e logjistikës, mirëpo edhe punëtorët e ndërtimitarisë dhe të punësuarit në sektorin e industrisë – përditë duhet ti nënshtrohen rrezikut të infektimit. Në parim shefi është përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit. Ai duhet të kujdeset që të ndërmerren masat e nevojshme dhe që, fjala bie, të ketë materiale të mjaftueshme mbrojtëse (dorëza, maska). Ai duhet ti informoi dhe udhëzoi stafin punonjës. Unia ka përgatitur materialin informues dhe listat kontrolluese për

sektorët e prekur, për të mundësuar lajmërimin e mangësive. Mbi 4000 lajmërimë mangësish Unia i ka përcjell më tej tek Suva dhe autoritetet. Pos kësaj Unia ka ushtruar presion, që bile të bëhen kontrole të mjaftueshme. Pasi që edhe konceptet më të mira nuk kryejnë punë, nëse nuk kontrollohet zbatimi i tyre.

**Të fuqizohet bashkëndikimi**

Në të gjitha çështjet, që prekin shëndetin e tyre, punonjësit kanë të drejtën e bashkëbisedimit. Ata duhet me kohë të informohen dhe propozimet e tyre duhet të degjohen. Kjo e drejtë e bashkëbisedimit gjatë krizës është anashkaluar. Unia dëshiron të zgjeron të drejtën e bashkëbisedimit dhe ta ankorojë atë më fuqishëm në Kontratën Kolektive të Punës.

Kërkesat vijuese janë mbi tavolinë:

- Krijimi i një komisioni shëndetësorë dhe të sigurisë në ndërmarrjet me të drejtë speciale të bashkëbisedimit
- Anketa të rregullta dhe të pavarura ndër punëmarrësit mbi zbatimin e masave të sigurisë dhe të shëndetit
- Mbrojtje posaçërisht për punëmarrësit e rrezikuar
- Zgjerim i të drejtës për të thënë «Ndal» në rast rreziku

Linku: [www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/arbeitssicherheit-gesundheitsschutz](http://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/arbeitssicherheit-gesundheitsschutz)





## 50 vite iniciativa-Schwarzenbach

## Ne kemi nxjerr mësimin tonë

Sikur të kishin fituar «republikanët» e James Schwarzenbach-ut në vitin 1970 me «iniciativën e tjetërsimit», unë sot nuk do të isha këtu. Prindërit e mi erdhën nga Italia në Zvicër për të punuar. Mbi 300 000 njerëz si prindërit e mi Schwarzenbach donte ti dëbonte nga Zvicra. Fuqia e mbetur punëtore e të huajve me një jetë në hije në periferinë e shoqërisë – pa familje, pa shanse të njëjta, pa të drejtë të zgjidhnin vendin e tyre të punës.

Vania Alleva

## Politika e fajtorëve kujdestarë

Schwarzenbach-u drejtohte frikën dhe zhgënjimin e popullatës zvicerane kundër sezonierëve. Ata, të cilët ndërtonin Zvicrën, Schwarzenbach-u i bënte fajtor kujdestar. Një numër i madh i punëmarrësve dhe bile edhe sindikalistë/e i besonin atij dhe kontribuuan për 46% të votave për.

Që atëherë diçka ka ndryshuar. Sindikatat kanë ngadhnyer të anulojnë statusin e sezonierëve dhe geton e barakave. Lëvizja e lirë e personave fuqizon të drejtat e një pjese të punëmarrësve pa pasaportë zvicerane. Për shumë nga ta Zvicra është bërë atdhe. Edhe për mua.

## S'ka Tempi pasati (kohë të kaluar)

Tempi pasati, gjithashtu? Mjerisht jo! Edhe sot ndërmarrjet në rend të parë janë të interesuara për fuqi punëtore të lirë dhe fleksibile. Dumpingu në paga, kushte të këqija e të pasigurta të punës, diskriminimi dhe papunësia janë pasojat. Dhe sikur atëherë provon të përfitojë një parti ksenofobe.



Një status i ri i sezonierëve për të huajt? Kushte të pasigurta të jetesës dhe të punës për të gjithë? Ne themi qartë «Jo» më 27 shtator! © Arkivi Social

Sot këtë rol famëkeq e luan SVP/UDC-ja. Iniciativa e saj anuluese donë të anulojë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të kthejë statusin jonjerëzor të sezonierëve – variantë kjo e aparteidit zviceran.

## Solidarizim kundër fushatës për gjetjen e fajtorëve kujdestarë

Miliarderët si Blocher-ët nuk janë pajtuar asnjëherë me të drejtat dhe masat e fituara

prej nesh për mbrojtjen e pagave kushteve të punës. Tani provojnë rishtas përmes një fushate për gjetjen e fajtorëve kujdestar që të pastrohet nga «të huajt»

Ne sindikatat kemi nxjerr mësimin tonë. Leksioni i mësuar është «Solidariteti», Ne nuk do të lejojmë të na përçajmë. Unia angazhohet për solidaritet. Këtë e garantoj unë. Pasi ë unë jam ende këtu.

## Greva e grave dhe «java vjollcë»

## Zvicra mobilizohet për barazi

Nga 8 deri me 14 qershor veçanërisht Unia është mobilizuar për të drejtat e grave! Një vit pas suksesit të madh të grevës së dytë të grave, barazia ende nuk është arritur. Sindikata kërkon më shumë respekt, më shumë kohë dhe më shumë pagë për gratë.

Nga Marie Saulnier Bloch

## Jubileu i grevës së grave

Më 14 qershor 2019 gratë në të gjithë Zvicrën kanë vu në provë me forcën dhe vendosmërinë e tyre, duke organizuar një ndër lëvizjet më të mëdha sociale në historinë e Zvicrës.

Në shenjë kujtimi të kësaj ngjarjeje Unia publikoi librin «Zvicra tundet – Greva e grave 2019», i cili është në dispozicion në faqen e saj të internetit\*. Fotot dhe tekstet tri-gjuhësore është mjaft i pasqyruar me pamje të grevave, aksioneve e demonstratave të 14 qershorit 2019 nga e gjithë Zvicra.

## Mobilizimet violete (ngjyrë vjollce)

«Edhe pse vetëdija feministe në Zvicër është, situata politike dhe realiteti konkret nuk është përmirësuar» thotë Aude Spang, sekretare e grave në Unia. Diskriminimi në paga, ngarkesat e dyfishta dhe trefishta si dhe mungesa e respektit janë pjesë e përditshmërisë së grave në Zvicër, veçanërisht e migrantëve. Edhe pse gratë përbëjnë gjysmën e popullatës, kontributi i tyre punues me apo pa pasaportë nuk është i pranuar apo i padukshëm sistematikisht.

Pa kontributin themelor të grave shoqëria nuk mund të funksionoi. Për këto arsye me 14 qershor 2020 u zhvilluan përsëri

mobilizime feministë në gjithë vendin. Gjatë «javëve violete» të sindikatave, të cilat filluan me 8 qershor, u mobilizuan gratë që nga Neunburg-u deri në Bellinzona. Përmes aksioneve të shumta denoncuan seksizmin dhe shtypjen që po zgjat edhe më tej. S'ka mbështetje të të gjithë punëtorëve pa mbështetjen e të gjitha punëtorëve: Unia shpreh qartë feminizmin, anti-racizmin dhe anti klasicizmin e saj (diskriminimi i bazuar në origjinën sociale dhe / ose pozitën sociale dhe ekonomike).

## Drejtësi sociale: Tani

Përkujdesa, puna e kujdesit në shtëpi, shitja me pakicë, logjistika: edhe gjatë pandemisë gratë qëndronin në vijën e parë të frontit! Sektori i kujdesit është i përbërë me 82% nga gratë, në shitje përqindja e grave është 65%. Aude Spang sqaron: «Vetëm duartrokitja si e tillë nuk mjafton; pasi puna e grave është njohur si me rëndësi relevante për sistemin, duhet edhe të trajtohet e të paguhet si e tillë. Për gratë Unia kërkon paga korrekte nga së paku 4000 franga x 13 (40 orë-java) dhe si kompensim për angazhimin e tre të madh dhe rreziqet, me të cilat janë përballur gjatë pandemisë, një premi prej 2000 frangave. Sindikata kërkon më shumë kontrolle në ndërmarrje, për të realizuar trajtimin e barabartë në paga, luftimi i vendosur i seksizmit dhe dhunës seksuale, racizmit, njohjen e punës në kujdestari në shtëpi private si punë dhe pushimin e etërve, i cili mund të ndahet mes prindërve. Porosia e librit: [www.unia.ch/publikationen](http://www.unia.ch/publikationen)



Sindikatat gjate «javes violete» që filloi me 8 qershor, mobilizoi gratë që nga Neunburg-u deri në Bellinzona

## Intervistë



**Marina Frigerio si vajzë e italianëve ka lindur në Zvicër. Ajo është një psikoterapiste me praktikën e saj në Bernë. Së bashku me Simone Burgherr më 1991 përmes librit «Fëmijët e fshehur: Fëmijët e sezonierë dhe prindërit e tyre tregojnë» bënë publike vuajtjet e fëmijëve të huaj. Pastaj vijoi me «Dhe, erdhën njerëz. Zvicra e italianëve», bashkë me Susanne Merhar, si dhe «Fëmijët e ndaluar».**

## Marina, ti ke përjetuar shumë të ashtuquajtura «iniciativa tjetërsimi». Si ka qenë për ty?

Thjesht e tmerrshme. Tek iniciativa-Schwarzenbach isha 11 vjeçe. Mendoja: nëse ajo kalon, unë duhet të largohem. Fëmijët dhe të rriturit tjerë thimbonin me fjalë marrëzrash: «Nesër ju do të largoheni». Një pozicion shumë i pakëndshëm për tu integruar. Unë isha e pikëlluar, por para së gjithash edhe e mlllefosur.

## Ti ke bërë publike situatën e fëmijëve të fshehur. Çka janë ata, «fëmijë të fshehur»?

Ishin fëmijët e sezonierëve. Ata nuk guxonin të banonin tek prindërit e tyre dhe fshiheshin apo rriteshin tek të afërmit apo nëpër shtëpitë e fëmijëve. Atëkohë thuhej se, në dollapët e sezonierëve kishte më shumë fëmijë se sa rroba.

Ishin kushte çnjerëzore. Me shumë njerëz tjerë ne provonim të sensibilizim shoqërinë për gjendjen e rënde dhe të pakënaqur dhe fituam luftën për të drejtën e shkollimit për të gjithë fëmijët në Zvicër, pavarësisht statusit të tyre.

Në vitet e 80-ta e 90-ta unë kam takuar shumë fëmijë dhe të rinj, të cilët nga kjo mënyrë jete ishin të traumatizuar dhe provoja t'ju ndihmoja. Kjo nuk mjaftonte. Ne duhej ti jepnim fund këtij turpi.

Fatmirësisht reagon organizatat më të rëndësishme për të drejta të fëmijëve. Unicef, Pro Familia, Pro Juventute denoncuan shkeljen e të drejtave të fëmijëve në Zvicër. Situata e fëmijëve-sezonierë u trajtua në prill të vitit 1991 në Nju Jork nga bordi i drejtorëve të Unicef-it. Ishte hera e parë, që u trajtua shkelja e të drejtave të fëmijëve në një vend të pasur. Ky ishte dhe është një skandal.

## SVP/UDC vazhdon të nis edhe më tej iniciativa të reja ksenofobe. Si është kjo për ty?

Unë e vërej, se fëmijët e migrantëve reagojnë njëjtë, sikur unë atëherë. Është pakëndshme, të shohësh gjithandë plakatë, të cilat paraqesin prindërit tu si kriminel dhe parazit.

Unë mendoj se iniciativat ksenofobe përbëjnë argumente, të cilat shkaktojnë reagime zorrësh. Mbrojtja e vendeve të punës, «zakone» tjera, kriminaliteti, gjithçka përzihet që në fund të gjinden po të njëjtit fajtorë kujdestar: «të huajt» janë fajtor për gjithçka.

Kur mendoj kush fshihet pas këtyre nismave, unë veç në dyshim se kanë të bëjnë me të drejta të punëtorëve dhe punëtorëve zviceran. Çka i intereson një filizi të një familje shumë të pasur si ajo Schwarzenbach, se si i ka punët këmbësoria? Përse nuk fillon Blocher tek firma e tij me të drejtat e punëtorëve? Gjithçka është për të hedhur rërë syje, për të marrë vota. Duhet menduar vetëm se çka bëjnë Blocher-ët në parlament. Ata janë zgjedhur në parlament edhe përmes votave të shumë punëtorëve, mirëpo shohin më tej vetëm interesat e tyre. Ksenofobia në politikë është rruga e thjeshtë për zë ardhur në pushtet. Kjo shihet edhe me Salvinin në Itali.

Unë i urrej këta politikanë, që dinë saktësisht, se programet e tyre përbëhen nga gënjeshtat dhe që nuk qajnë kokës se çfarë pasojash për shoqërinë kanë ato.

## Në shtator do të votohet për iniciativën anuluese. Kjo donë të anulohet lëvizjen e lirë dhe të fus një status të ri të sezonierëve. Çka domethënë kjo për ty?

Rikthimi i statusit të sezonierëve do të ishte një katastrofë etike e njerëzore. Është dokumentuar mjaftueshëm se çfarë turpi ishte!

Zvicra nuk mund të fshehet pas kufijve të saj: Këto janë ide mesjetare. Të parët që do të humbasin do të jenë shumë të rinj e të reja zvicerane, që arsimohen e trajnohen jashtë Zvicrës, ku duan të grumbullojnë përvoja të reja. Ne jemi duke jetuar në një botë lëvizëse. Gjithçka është e rrjetëzuar dhe ndërlidhur. Vetë mbyllja domethënë vet kastrim. Pos kësaj aprovimi do të linte një shije të hidhur tek shumë bashkëqytetarë/e pa pasaportë zvicerane.

Ne të gjithë kemi interes që të gjithë të ndihen mirë këtu. Përndryshe integrimi i ndërsjellë do të dështojë!

Marilia Mendes



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

**Shkarkimi: A zgjatet afati i shkarkimit në rast sëmundjeje?**

Firma ime më ka shkarkuar në mënyrë të rregullt. Pak kohë pas kësaj unë jam sëmurë për 5 ditë. Afati i shkarkimit përbënë një muaj. A është problematike, nëse unë menjëherë pas shërimit të suksesshëm lajmërohem si i papunë?



SHKARKIMI: Firma edhe në rast sëmundjeje ti përmbahet afateve të shkarkimit. (Foto: iStock)

NICOLE DEBRUNNER: Po. Pasi me rastin e sëmundjes zgjatet afati i shkarkimit. Pasi tek ju me rastin e lajmërimit menjëherë pas shërimit nuk do të ishte respektuar afati i shkarkimit, sigurimi i papunësisë do të duhej të merrte përsipër hapësirën kohore të afatit të shkarkimit. Sidoqoftë, nuk është e përshtatshme që ajo dhe publikun e gjerë që të ofrohen shërbime për një periudhë që në të vërtetë do t'i detyrohej firmës. Andaj, arka e papunësisë do të kërkojë nga ju, që t'ia bëni me dije firmës suaj se ajo është e detyruar të merr parasysh zgjatjen e afatit shkarkues dhe që të përpunojë pjesën e mbetur të afatit shkarkues. Nëse nuk e ndiqni këtë kërkesë, do të sanksionoheni. Nëse firma refuzon ofertën e punës, arka do tua paguajë menjëherë mëditjet. Mirëpo ajo shumë e paguar, e cila i përgjigjet afatit të periudhës së shkarkimit në fjalë, do t'ia kërkojë firmës.

Work, 15. 5. 2020

**Grupet e rrezikut: A duhet megjithatë të punoi në shërbim kamerieri?**

Unë jam i punësuar si kamerier. Që nga shpërthimi i epidemisë korona në Zvicër të gjithë ne kishim punë me kohë të shkurtuar. Tani restoranti është hapur përsëri dhe neve na duhet të shkojmë përsëri në punë. Në të vërtetë unë kam një sëmundje kronike të mushkërive, andaj i takoi grupit të rrezikuarve. Kontakti me myshterijtë më shqetëson. A duhet megjithatë të shkoj prapë në punë?

David Aeby: Jo. Për punët tuaj nuk është e mundur puna nga shtëpia (Homeoffice): dhe si kamerier është thuajse se a pamundur të mbroheni nga kontaktet ndërnjerëzore. Andaj guxon të refuzoni punën dhe megjithatë të kërkonit pagën e plotë nga punëdhënësi juaj (Neni 10c Urdhëresa-Covid-2)Për këtë ju nevojitet një test mjekësor, i cili vërteton për ju që i takoni grupit të rrezikuar dhe për këtë arsye puna juaj për ju nuk është e arsyeshme. Këtë test mjekësor duhet t'ia dorëzoni shefit tuaj. Firma juaj pos tjerash ka mundësinë që për ju të regjistrojë punën me kohë të shkurtuar, pasi ju i takoni grupit të rrezikut.

Work, 29.5.2020



MBROJTJA: Pacientët e rrezikuar nga korona nuk duhet të punojnë në shërbim kamerieri, mirëpo marrin pagën e plotë. (Foto: Keystone)


### Koronavirusi: Çka duhet të dini

Pyetje dhe përgjigje të shumta rreth koronavirusit dhe të drejtave tuaja në vendin e punës i gjeni në shumë gjuhë në: [www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/coronavirus](http://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/coronavirus).

## Kriza e koronës dhe udhëtimi për në vendlindje Zvicra hapi kufijtë me vendet e shteteve të BE/EFTA-s

Qeveria federale e Zvicrës bazuar në zhvillimet e situatës së pandemisë, nga 15 qershori hap kufijtë për vendet e BE-së dhe EFTA-s, si dhe Britaninë e Madhe dhe heq kufizimet e hyrjes që kanë qenë në fuqi që nga marsi. Ky vendim vlen edhe për shtetasit/et e vendeve të treta që jetojnë në BE, një vend të EFTA ose në Mbretërinë e Bashkuar, që gjithashtu mund të hyjnë në Zvicër.

Osman Osmani



Përveç pasaportës së tyre, kërkohet që shtetasit/et e vendeve të treta të paraqesin një vërtetim që konfirmon vendbanimin e tyre në njërin nga këto shtete. Aktualisht nuk është e qartë nëse nga mesi i qershorit do të zbatohen masa sanitare kufitare. Enti Federal për Shëndetësi është duke shqyrtuar se a do të jenë të nevojshme kontrollet shëndetësore në kufi nga 15 qershori. Me këtë rast do të merrret parasysh se çfarë masash marrin vendet e tjera fqinje dhe të BE-së.

### Disa nga vendimet aktuale të qeverisë federale

#### 1. Rasti i personave me afate të skaduar të qëndrimit.

Personat të cilët nuk kanë mundur të lëshojnë Zvicrën para afatit të caktuar në Vizën turistike deri në 90 ditë, pra të cilët për shkak të rrethanave janë detyruar të qëndrojnë më gjatë në Zvicër, gjatë largimit nga Zvicra nuk guxojnë të dënohen. Ditët e «tepërta» të qëndrimit do t'u zbriten me rastin e një qëndrimi të serishëm. Pra nëse dikush ka qëndruar 30 ditë më tepër në Zvicër, atëherë me rastin e ardhjes së serishme në Zvicër ka të drejtë të qëndroj maksimalisht 60 ditë (nëse parashihet qëndrimi për 90 ditë). Hyrja e serishme në Zvicër për njerëzit me të drejtë udhëtimi pa vizë, është i mundur pas një ndërprerje apo qëndrimi prej më së paku 90 ditësh jashtë Zvicrës.

Shtetasit e vendeve të treta që janë tashmë legalisht në zonën e BE/EFTA mund të udhëtojnë nëpër Zvicër, edhe për qëllime turistike, me kusht që të plotësojnë kushtet e zakonshme të hyrjes.

Shtetasit e vendeve të treta që vijnë nga një vend i tretë nuk mund të udhëtojnë nëpër Zvicër në një vend tjetër të BE / EFTA për qëllime turistike.

#### 3. Vendimet e vendeve përkatëse të BE-së mbi rregullat e udhëtimit

Nga e hëna, më 15 qershor kufijtë e brendshëm të BE janë duke u hapur gati plotësisht. Këtë e ka bërë të mundur zhvillimi i favorshëm i luftimit të pandemisë në këto vende. Evropa juglindore çalon prapa dhe me gjasë do të fillojë hapjen e kufijve tek nga një 1 korrik.

Siç ka njoftuar «Deutsche Welle»: Komisioni Europian u ka rekomanduar vendeve anëtare që nga 1 korriku, në varësi të zhvillimit të pandemisë, të heqë kufizimet e udhëtimit me vende, situata epidemiologjike e të cilave i përgjigjet mesatares së BE dhe ku ka kapacitete të mjaftueshme për të trajtuar virusin. Në fillim në këtë listë të heqjes së kufizimeve do të duhet të qëndrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Kosova, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi e Bosnja.

**Austria** nga 16 qershori hap kufijtë e saj me të gjitha shtetet që kufizohet. Edhe deri më tani në Austri mund të hyjë nga: Gjermania, Lihtenshtajni, Zvicra, Sllovakia, Sllovenia, Republika Çeke dhe Hungaria. Përfshijmë ka për Suedinë, Spanjën, Portugalinë dhe Britaninë e Madhe.

Edhe kufiri me **Italinë** hapet plotësisht. Që nga 3 qershori, hyrja në Itali lejohet përsëri për të gjitha vendet e BE/EFTA pa

karantinë.

**Sllovenia dhe Kroacia** kanë hequr kufizimet e hyrjes për Austrinë dhe nëntë vendet e tjera të BE qysh në fund të majit.

#### 4. Rregullat aktuale të udhëtimit në vendet e Evropës juglindore

Hyryra në Bosnje dhe Hercegovinë që nga 21 maji i vitit 2020 është e lejuar si për shtetasit e Bosnjës dhe Hercegovinës, ashtu dhe për shtetasit e huaj. E njëjta vlen edhe për transitin e shtetasve të huaj, të cilët duhet të udhëtojnë përmes Bosnje-Hercegovinës në vendin e tyre të lindjes ose në vendbanimin.

**Serbia** ka hequr që nga 22 maji çdo pengesë sa i përket udhëtimit hyrës dhe dalës në vend

Që nga 1 qershori, udhëtimi nga Zvicra për në **Mal të Zi** është përsëri e mundur. Nuk ka kërkesë për karantinë.

Në **Maqedoni të veriut** mund të hyjnë të gjithë ata që kanë leje qëndrimi dhe shtetasit maqedonas, por në përgjithësi mund të jenë të detyruar nga momenti i hyrjes të vendosen në karantinë për 14 ditë në objektet shtetërore. Udhëtarët transit gjithashtu nga 15 qershori mund të hyjnë në vend me ç' rast duhet që të deklarojnë se do të kalojnë rrugën në vend për 5 orë dhe këtë deklaratë ta dorëzojnë me rastin e daljes jashtë vendit.

**Shqipëria** i ka rihapur më 1 qershor 2020 kufijtë tokësor. Në thelb nuk ka kërkesë për karantinë pas hyrjes në vend. Udhëtimi përmes rrugës detare – aktualisht (16.6.) është i mundur vetëm për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

Në **Kosovë** aktualisht (11.06.2020) deri në njoftimin e mëtejshëm, vlejnjë masat e vendosura nga autoritetet të ndalimit të hyrjes edhe për udhëtarët nga Zvicra, Gjermania, Italia e Franca, që janë në fuqi nga 13 Mars 2020. Nga 22 qershori do të hapen edhe pikat tjera kufitare me vendet fqinje. Fluturimit e parapara në dhe nga aeroporti Adem Jashari që janë planifikuar të zhvillohen nga 15.6., shkaku i rritjes së numrit të infektuarve në Kosovë janë anuluar dhe he për he edhe sipas agjencive të fluturimeve janë edhe shtyrë për më vonë dhe varen nga zhvillimet e luftimit të koronavirusit.



Në **Kosovë** aktualisht (16.06.2020) deri në njoftimin e mëtejshëm, vlejnjë masat e vendosura nga autoritetet të ndalimit të hyrjes edhe për udhëtarët nga Zvicra, Gjermania, Italia e Franca, që janë në fuqi nga 13 Mars 2020. Nga 22 qershori do të hapen edhe pikat tjera kufitare me vendet fqinje. Fluturimit e parapara në dhe nga aeroporti Adem Jashari që janë planifikuar të zhvillohen nga 15.6., shkaku i rritjes së numrit të infektuarve në Kosovë janë anuluar dhe he për he edhe sipas agjencive të fluturimeve janë edhe shtyrë për më vonë dhe varen nga zhvillimet e luftimit të koronavirusit.